



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 20 gusht 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet e mëposhtme:

- ♦ Licencimi i “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k.

U miratua licencimi i shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike nga impianti fotovoltai me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, për një afat 30-vjeçar.

Licencimi shoqërohet me kushte dhe detyrime lidhur me vijimin e projektit, fillimin e punimeve dhe të ushtrimit të veprimtarisë, si dhe raportimin pranë ERE-s.

- ♦ Modifikimi i licencave të “ERSEKA SOLAR PARK 1” dhe “ERSEKA SOLAR PARK 2” sh.p.k.

U vendos pezullimi i procedurave për përfshirjen e njësive të depozitimit të energjisë elektrike, si vepra ndihmëse, në projektet e centraleve fotovoltaike me kapacitet të instaluar 20 MW secili, pa ndryshuar kapacitetin total të centraleve.

Pezullimi lidhet me kërkesën e paraqitur nga ortaku i shoqërive pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për verifikimin e përmbushjes së kushteve ligjore dhe kontraktore për përfshirjen e njësive të depozitimit në projektet përkatëse.

- ✦ Procedurat do të vijojnë pas administrimit të qëndrimit të MIE-s mbi çështjet e ngritura.

📄 Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.